

11 Qershor 2020

Hyn në fuqi që nga e hëna versioni i ri i urdhëresës me lehtësime të mëtejshme për mbrojtjen nga koronavirusi

Janë bërë të mundshme evenimente të caktuara me më shumë se 100 persona dhe evenimente festive private me deri në 50 persona nën kushte të caktuara / Lejohen sportet me kontakt fizik në ambiente të mbyllura me deri në dhjetë njerëz dhe në ambiente të hapura me deri në 30 njerëz / Mund të hapen ambiente të tjera argëtimi dhe të kohës së lirë

Qeveria e Republikës ju komunikon:

Duke filluar që nga e hëna, më 15 Qershor 2020, hyjnë në fuqi në Nordrhein-Westfalen adaptime të mëtejshme të masave për mbrojtjen nga koronavirusi. Përveç lehtësimit të kufizimeve të hyrjes në biznese për sa i përket sipërfaqes, këto kanë lidhje me evenimente dhe grumbullime me më shumë se 100 spektatorë, të cilat janë sërish të mundshme nën kushte të caktuara, veçanërisht për gjurmimin e pjesëmarrësve. Gjithashtu dhe festime private në raste të veçanta si përvjetorë, dasma, pagëzime, ditëlindje ose diplomime mund të zhvillohen me maksimumi 50 pjesëmarrës, duke ju nënshtruar kërkesave për gjurmueshmërinë dhe masave paraprake për higjienën dhe mbrojtjen. Për më tepër, baret dhe gjithashtu ambientet e relaksimit dhe pishinat e argëtimit mund të fillojnë veprimtarinë e tyre në kushte të caktuara. Lehtësimit vlejné gjithashtu për sportet me kontakt fizik. Nga e hëna e tutje, stërvitja në sportet me kontakt fizik lejohet gjithashtu në hapësira të mbyllura për grupe deri në dhjetë njerëz dhe në hapësira të hapura për grupe deri në 30 persona. Konkurset e sporteve popullore dhe të kohës së lire mund të zhvillohen sërish në salla nën kushte të caktuara.

Mbeten në fuqi rregulloret themelore për sa i përket kufizimit të kontaktit në hapësira publike dhe detyrimi i përdorimit të maskës për gojën dhe hundën në zona të caktuara me sasi të madhe publiku dhe klientësh. Evenimentet madhore do të qëndrojnë gjithashtu të ndaluara deri më 31 Gusht 2020.

Zhvillimi pozitiv i rasteve të infeksionit në Nordrhein-Westfalen e bën të mundur adaptimin e masave të mëtejshme për mbrojtjen nga koronavirusi. Për shembull, numri i infeksioneve të reja në Nordrhein-Westfalen ka rënë me më shumë se 75 përqind që nga hapjet e para në 20 Prill. Ky zhvillim fuqizon qeverinë e Republikës në rrugëtimin e saj në pandeminë e koronavirusit. Sjellja e kujdesshme dhe e përgjegjshme e pjesës madhore të individëve lejon ndërmarrjen e këtyre hapave të mëtejshëm në rrugëtimin drejt një normaliteti të përgjegjshëm. Hapjet dhe adaptimet e moderuara të masave të mbrojtjes zënë vend nën vlerësimin e vazhdueshëm të përhapjes së infeksionit.

Versioni i ri i urdhëresës së koronavirusit hyn në fuqi të hënën më 15 Qershor 2020 dhe vlen fillimisht deri në 1 Korrik 2020. Është i gatshëm tek www.land.nrw.

Rregulloret e reja të detajuara

Urdhëresa e adaptuar për mbrojtjen nga koronavirusi mundëson risitë e mëtejshme duke filluar nga 15 Qershori 2020:

1. Ngjarje festive dhe evenimente

Evenimente

Evenimentet dhe mbledhjet me deri në 100 persona lejohen nën kushtet e masave paraprake të distancës dhe të mbrojtjes. Këtu përfshihen rregulloret për higjienën, kontrollin e hyrjes, garancia e një distance prej minimumi 1.5 metrash dhe gjurmueshmëria e spektatorëve dhe pjesëmarrësve. Kërkesa të mëtejshme vlejné për evenimente me më shumë se 100 spektatorë. Këto vlejné vetëm në koordinim me autoritetin shëndetësor përkatës.

Ato kërkojnë gjithashtu një plan të veçantë për higjienën dhe për mbrojtjen nga infeksionet. Për evenimente me vende të palëvizshme, rregullorja e distancës prej 1.5 metrash mund të hiqet nëse planifikohen vendet ku personat do të ulen dhe sigurohet gjurmimi i pjesëmarrësve. Kjo vlen gjithashtu për mundësitë edukative jashtëshkollore ose evenimentet kulturore, nëse janë të gatshme vendet e palëvizshme.

Kërkesat për gjurmueshmërinë mundësojnë regjistrimin e të dhënave të pjesëmarrësve dhe krijimin e një plani ulje i cili ka ngrënë çdo person i pranishëm.

Evenimente festive madhore si për shembull festivalet popullore, festivalet e qyteteve, fshatrave, të rrugëve, të qitjeve dhe evenimente të ngjashme festive do të qëndrojnë të ndaluara deri të paktën më 31 Gusht 2020. Kjo vlen gjithashtu për festivale muzike, festivale dhe evenimente të ngjashme kulturore gjithashtu dhe festivale sporti.

Evenimente festive private

Evenimentet me karakter shoqëror privat qëndrojnë të ndaluara. Përjashtime vlejné për festimet në raste të veçanta si për shembull përvjetore, dasma, pagëzime, ditëlindje dhe ceremoni diplomimi të cilat mund të përsëriten në kushte të caktuara. Këto evenimente festive janë të mundshme me maksimumi 50 pjesëmarrës, me kusht që të vëzhgohen rregullat e higjienës dhe pjesëmarrësit të regjistrohen për sa i përket gjurmueshmërisë. Në këto kushte, vendosja e maskave për gojën dhe hundën mund të shmanget për shembull në martesë civile ose në kthimin në grup pas një varrimi. Këto festime mund të zënë vend sërish në dhoma të ndara në ambiente gastronomike dhe në hotele.

2. Tregëtia, muzetë dhe gastronomia

Lehtësimet vlejné duke filluar nga 15 Qershori gjithashtu dhe për kufizimet e hyrjes në biznese për sa i përket sipërfaqes. Këto do të rriten nga një person për dhjetë metër katror në një person për shtatë metër katror të hapësirës së shitjes në dyqan. Kjo vlen gjithashtu për kufizimet e vizitorëve në muze dhe ekspozita, kopshte zoologjike dhe parqe kafshësh.

Baret mund t'i rifillojnë sërish veprimtaritë në koordinim me standartet e higjienës dhe të mbrojtjes nga infeksioni, të cilat janë të vlefshme dhe për pjesën e mbetur të sektorit të gastronomisë. Klubet dhe diskotekat do të vazhdojnë të jenë të mbyllura. Ambientet ku zhvillohet prostitucioni, shtëpitë publike dhe institucione të ngjashme do të vazhdojnë të jenë të ndaluara.

3. Ambientet e argëtimit dhe të kohës së lirë

Barbekjutë lejohen sërish duke filluar nga 15 Qershori në ambiente ose vende publike .

Tregjet e sendeve të lira dhe të sendeve të përdorura mund të zënë vend nën kushtet e një plani të veçantë higjiene dhe mbrojtjes nga infeksioni. Parqe të përkohshme argëtimi nga një numër i madh i operatorëve të hapësirave të argëtimit mund të aprovohen gjithashtu nën kushtet e një plani mbrojtje nga infeksioni dhe higjiene dhe në koordinim me autoritetet përkatëse.

Ambientet e relaksimit dhe të saunave mund të rifillojnë veprimtaritë e tyre nën kushtet e standarteve të mbrojtjes nga infeksioni dhe të higjiensës. E njëjta gjë vlen për pishinat e argëtimit dhe të. Nuk vlen më kufizimi i përdorimit të pishinave me korsii.

4. Sporti

Duke filluar nga e hëna, stërvitja në sportet me kontakt fizik lejohet sërish në dhoma të mbyllura për grupe deri në dhjetë persona, të afërm në vijë direkte ose pjesëtarë të dy bashkësive familjare. Sportet me kontakt fizik mund të zhvillohen në grupe deri në 30 persona në mjedise të hapura. Në të dyja rastet duhet të sigurohet një gjurmueshmëri e pjesëmarrësve nëpërmjet mbledhjes së të dhënave.

Konkurset në sporte popullore dhe të kohës së lirë lejohen gjithashtu në ambiente dhe salla të mbyllura, nën kushtin e një plani higjiene dhe të mbrojtjes nga infeksioni.